

Bilanci i energjisë elektrike

Viti 2021


Tiranë, më 3 Mars 2022: Gjatë vitit 2021, energjia elektrike në dispozicion u rrit me 10,9 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 8.963 GWh nga 5.313 GWh energji të prodhuar në vitin 2020, duke shënuar një rritje të prodhimit me 68,7 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 59,6 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 39,9 % dhe nga të tjerë prodhues (Fotovoltaikë) në masën 0,5 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) arriti vlerën 2.253 GWh nga 3.239 GWh që ishte një vit më parë, duke shënuar kështu një rënie me 30,4 %. Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 2.800 GWh nga 963 GWh duke shënuar një rritje me 2,9 herë (tab.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Për publikim 03/03/2022

Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike, vjetorë

MWh

Treguesit	2020	2021
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	7.588.636	8.414.808
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	5.313.032	8.962.703
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	5.280.767	8.921.947
a Publike (a=a.1-a.2)	3.090.198	5.343.974
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	3.121.234	5.392.709
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	31.037	48.735
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	2.190.569	3.577.973
1.3 Të tjerë prodhues (Fotovoltaikë)	32.266	40.756
2 Importi bruto (energji në marrje)	3.238.631	2.252.548
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	963.027	2.800.443
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	7.588.636	8.414.808
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1.630.632	1.784.871
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	172.197	227.918
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	1.458.435	1.556.953
a Humbjet teknike në shpërndarje	932.634	1.028.670
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	525.801	528.283
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	5.958.004	6.629.937
2.1 Familjarë	2.965.540	3.089.500
2.2 Jo Familjarë	2.992.464	3.540.437


¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

² Humbjet jo- teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Hidrocentralet publike, në vitin 2021, prodhuan 5.344 GWh nga 3.090 GWh të prodhuar në vitin 2020, duke shënuar kështu një rritje të prodhimit me 72,9 %. **Hidrocentralet private dhe koncensionare**, prodhuan 3.578 GWh nga 2.191 GWh të prodhuar një vit më parë, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 63,3 %.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në vitin 2021, ka arritur vlerën pozitive prej 548 GWh, krahasuar me vitin 2020 ku kishte një vlerë negative prej 2.276 GWh (fig.2).


Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike



Humbjet në rrjet kanë arritur vlerën 1.785 GWh nga 1.631 GWh, duke shënuar kështu një rritje me 9,5 %. **Humbjet në transmetim** janë rritur me 32,4 % dhe pesha që zënë në totalin e humbjeve në rrjet është 12,8 %.

Humbjet në shpërndarje zënë një peshë më të madhe, rreth 87,2 % të humbjeve në rrjet dhe janë rritur me 6,8 %, krahasuar me vitin 2020 (fig.3).


Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2021, arriti vlerën 6.630 GWh nga 5.958 GWh që ishte në vitin 2020.


Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë u rrit me 4,2 %, duke arritur vlerën 3.090 GWh nga 2.966 GWh që ishte në vitin 2020, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u rrit me 18,3 %, duke arritur vlerën 3.540 GWh nga 2.992 GWh që ishte një vit më parë (fig.4).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



Në fig.5 paraqitet **struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve** për periudhën 2017-2021. Në vitin 2021 kemi një rritje të prodhimit neto në tremujorin e parë dhe të dytë dhe një rënie të prodhimit neto në tremujorin e tretë dhe të katërt, krahasuar me vitin 2020.

Fig. 5 Struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve, 2017-2021 (%)



Tremujori IV 2021

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, **energjia elektrike në dispozicion** u rrit me 5,4 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 1.588 GWh nga 1.300 GWh energji të prodhuar në tremujorin e katërt të vitit 2020, duke shënuar një rritje të prodhimit me 22,1 % (tab.2).

Tab. 2 Bilanci i energjisë elektrike, tremujori IV

MWh


Treguesit	Tr. IV 2020	Tr. IV 2021
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	2.021.663	2.131.434
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1.300.103	1.587.703
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	1.294.159	1.581.253
a Publike (a=a.1-a.2)	799.221	850.283
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	807.360	858.838
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	8.139	8.555
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	494.938	730.970
1.3 Të tjerë prodhues (Fotovoltaikë)	5.944	6.450
2 Importi bruto (energji në marrje)	974.710	950.218
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	253.150	406.487
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	2.021.663	2.131.434
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	422.820	424.235
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	44.690	48.299
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	378.130	375.936
a Humbjet teknike në shpërndarje	243.145	253.106
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	134.985	122.830
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.598.843	1.707.199
2.1 Familjarë	773.026	803.153
2.2 Jo Familjarë	825.817	904.046

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

² Humbjet jo- teknike përbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, importet bruto të energjisë elektrike (energji në marrje) u ulën me 2,5 % dhe eksportet bruto të energjisë elektrike (energji në dhënie) u rritën me 60,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (fig.6).


Fig. 6 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, **humbjet në transmetim** janë rritur me 8,1 %, ndërsa **humbjet në shpërndarje** kanë rënë me 0,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët u rrit me 6,8 %. **Përdorimi nga konsumatorët familjarë** u rrit me 3,9 %, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u rrit me 9,5 % (fig.7).

Fig. 7 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liçensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.